

## FTESË PËR OFERTË për:

### “Perzgjedhje Kompani per prodhim mobilje per Union Bank“

I/ E Nderuar Zoteri / Zonje

Union Bank Sha fton të gjitha Kompanite e interesuara në procedurën e Tenderimit për “Perzgjedhje Kompani per prodhim mobilje per Union Bank“

Qëllimi i kësaj Ftese për Ofertë është pranimi; vlerësimi dhe perzgjedhja e Propozimit/Propozimeve më të mirë që përmbush kërkesat e Bankës, sipas listes se produkteve të kerkuara.

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese:

- Vlerësimi mbi cilesinë dhe dokumentacionin teknik për shërbimet e kërkuara.
- Vlerësimi mbi bazën e cmimit më të mirë dhe final të ofruar nga kompania për shërbimet e kërkuara.

**Te gjitha kompanite e interesuara per te marre pjese ne kete process jane te lutura qe te kontaktojne ne: [procurement@unionbank.al](mailto:procurement@unionbank.al) deri me date 20 Shkurt 2025, ne menyre qe t’ju mundesohen dokumentat e tenderit**

Me respekt

Zj. Suela Bokshi

Drejtori i Divizionit te Operacioneve dhe  
Anetar i Drejtorise Ekzekutive



Zj. Marika Martiri



Drejtor i Departamentit te Administrates

Tiranë më, 17 Shkurt 2025

## 1. Hyrje

Union Bank (me poshte quajtur “Banka ose “UB”) është një institucion financiar i regjistruar si bankë tregtare më 9 Janar 2006. Për më shumë informacion në lidhje me aktivitetin, madhësinë dhe gjendjen financiare të Bankës, ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit: [www.unionbank.al](http://www.unionbank.al)

## 2. Objekti i Fteses per Oferte

Union Bank fton kompani vendase të kualifikuara për të paraqitur një propozim për: “Perzgjedhje Kompani per prodhim mobilje per Union Bank”.

Objektivi i kësaj Ftese per Oferte është të kërkojë oferta nga kompanitë e kualifikuara për përmbushjen e kërkesave siç përshkruhet në seksionin e specifikimeve. Shërbimi do të realizohet për Rrjetin e Degëve të Bankes dhe për Zyrat Qendrore sipas kërkesës së Bankës.

Si rezultat i kësaj kërkesë, do të lidhet një kontratë me çmim fiks per njesi sipas zerave për furnizuesin/t i/e zgjedhur. Per kohezgjatjen e Kontrates do të diskutohet dhe vendoset me Kompanine e perzgjedhur.

**Shënim: Ofertimi i pjesshem per realizim te vetem nje pjese te punimeve te kerkuara nuk eshte i lejuar dhe ofertat do te merren ne konsiderate per vleresim.**

!Nënkontraktimi nuk do të lejohet gjatë realizimit të kontratës, përveç rasteve kur miratohet paraprakisht nga Banka. Në rast se verifikohet, do të çojë në ndërprerje të menjëhershme të Kontratës.

Për të siguruar të njëjtin nivel informacioni për të gjithë pjesëmarrësit, çfarëdo përgjigje apo sqarimi shtesë që Banka do t'i japë një prej kompanive të interesuara, do të ndahet me pjesën tjetër të pjesëmarrësve në këtë proces.

Dokumentacioni Teknik dhe Financiar i kërkuar duhet të dorëzohet me zarf të mbyllur brenda datës **03 Mars 2025**, në adresën e mëposhtme:

*Departamenti i Administrates*

*Union Bank SHA*

*Bulevardi Zogu I, Sheshi Ferenc Nopça, Nd. 5, H. 3, Njësia Bashkiake Nr. 9, Kodi Postar 1016, Tiranë, Shqipëri*

me referencë **“Perzgjedhje Kompani per prodhim mobilje per Union Bank”**

Ose ne version Elektronik me email në adresen [procurement@unionbank.al](mailto:procurement@unionbank.al)

Formati i propozimit duhet të përmbajë listën e dokumentacionit të përfshirë në Anekset bashkëlidhur Fteses per Oferte.

## 3. Pershkrimi Sherbimeve te kerkuara

Banka synon qe te perzgjedhe kompani qe mund te ofrojne sherbimet per Perzgjedhje Kompani per prodhim mobilje per Union Bank kur te linde nevoja per ne rrjetin e degëve te saj dhe Zyrat Qendrore.

Per realizimin e sherbimeve te kerkuara, ju do te kuotoni referuar listes se zerave bashkangjitur ne Anekse.

### **Shenim i rendesishem:**

Oferta Financiare te plotesohet ne tabelen **Excel** dhe te dergohet ne dy formate ne tablele excel e aksesueshme dhe format PDF

#### 4. Skeduli i Procesit të Tenderimit

<b>Data</b>	<b>Koment</b>
17 Shkurt 2025	Publikimi i Fteses per Oferte
20 Shkurt 2025	Afati per dergimin e pyetjeve nga Kompanite
24 Shkurt 2025	Afati per kthimin e pergjigjeve nga Banka
03 Mars 2025	Afati per dorezimin e Propozimeve
15 Mars 2025	Njoftimi nga Banka mbi rezultatet e vleresimit
25 Mars 2025	Pregatitja e Kontrates dhe nenshkrimi me Fituesin

Bashkëlidhur Ftesës për Ofertë do të gjeni:

- Shtojca 1. Kerkesat per dokumentacionin teknik
- Shtojca 2. Kerkesat per Propozimin Financiar te pergjithshem
- Shtojca 3. Kerkesa per oferte per projekt dege te specifikuar
- Shtojca 4. Draft Kontrate Tip

## **Shtojca 1      Lista e Dokumentacionit teknik**

### **Propozimi Teknik:**

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentat e mëposhtëme:

1. Kopje të ekstraktit të QKB (të 6 muajve të fundit)
2. Prezantim/kredencialet e Kompanisë ku të theksohen kapacitetet, resurset,
3. Prezantim projektesh të realizuara me foto, detaje mbi vendosdhjen dhe nderhyrjet etj.
4. Numri i Stafit me deklaratë konfirmimi nga autoritetet qeveritare (stafi i siguruar sipas legjislacionit tatimor dhe atij të punës në fuqi),
5. Leter Reference nga klientet kryesore për realizim shërbimesh të ngjashme.
6. Çdo dokument tjetër shtesë që mund të shërbejë kësaj Ftese për Ofertë.

Të gjithë dokumentat sipërpërmendura duhet të jenë të aksesueshëm dhe të lexueshëm në momentin e dërgimit të tyre. Mos-dorëzimi i një dokumenti ose të dokumentave të pasakta, do të sjellë penalitet në vlerësimin që do realizohet ose do të konsiderohen si kushte për skualifikim nga ky proces.

### **Kriteret për kualifikimin e Kompanive pjesëmarrje në proces:**

- Eksperiencë në tregun vendas për realizim të shërbimeve të kërkuara (minimumi 3 vjet),
- Shërbime të ngjashme të mëparshme me banka të tjera dhe/ose korporata të mëdha.
- Resurset teknike dhe financiare për të përmbushur kërkesat e bankës.
- Raporti Cmim – Cilesi - Vlerësohet jo vetëm cmimi por edhe cilesia e punimeve të ofruara.
- Të aftë për të ofruar shërbimet e kërkuara në të gjithë rrjetin e UB në të gjithë Shqipërinë. Për listën e detajuar të rrjetit UB referojuni faqes së internetit të UB: [www.unionbank.al](http://www.unionbank.al)

## **Shtojca 2      Lista e Sherbimeve te Kerkuara per Oferte Financiare**

Bashkangjitur Fteses per Oferte do te gjeni listen e zerave te kerkuara per prodhimin e mobiljeve, mbi te cilat ju do te jepni propozimin tuaj Financiar.

Duke qene se planifikohen edhe punime jashte Tirane, duhet te ofertohet sipas kerkesave.

Ne Oferten Financiare, monedha do të jetë në Lek me TVSH te perfshire.

Ne oferten financiare duhet te vendosni kushtet e pageses qe ju propozoni.

### **Shenim i rendesishem:**

Oferta Financiare te plotesohet ne tabelen **Excel 1** dhe te dergohet ne dy formate ne tabele excel e aksesueshme dhe format PDF

## **Shtojca 3      Kerkesa per oferte per projekt dege te specifikuar**

Bashkangjitur Fteses per Oferte do te gjeni listen e zerave te parashikuar per realizimin e mobiljeve sipas projektit, mbi te cilat ju do te jepni propozimin tuaj Financiar.

Ne Oferten Financiare, monedha do të jetë në Lek me TVSH te perfshire.